

BANKA E SHQIPËRISË

MODELI MAKROEKONOMETRIK I SHQIPËRISË: STUDIM VIJUES

VASILIKA KOTA,
ELONA DUSHKU*



PËRMBAJTJA

<i>Përmbajtja</i>	3
<i>Abstrakt</i>	5
<i>I. Hyrje</i>	6
<i>II. Zhvillimet gjatë vitit 2007</i>	8
<i>III. Skema e re e mekanizmit të transmetimit</i>	10
<i>IV. Simulimet</i>	13
<i>IV.1 Një zhvlerësim i kursit nominal të këmbimit</i>	14
<i>IV.2 Rritje në konsumin e qeverisë</i>	16
<i>IV.3 Një goditje negative oferte</i>	17
<i>IV.4 Rritja e kërkesës botërore</i>	19
<i>Përfundime</i>	20
<i>Referenca</i>	22
<i>Shënime</i>	23

ABSTRAKT

Ky punim është vazhdimi i një materiali paraardhës të titulluar “Modeli makroekonometrik për Shqipërinë”. Qëllimi i tij është prezantimi i ecurisë së makromodelit gjatë vitit 2007. Aktualisht, modeli është i pasuruar me anën e ofertës së ekonomisë dhe sektorin fiskal, si dhe përfshin kanalet kryesore të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare. Kemi aplikuar një metodë të re të disagregimit të vlerave, nga vjetore në tremujore dhe gjithashtu, kemi përfshirë përkufizime të reja për disa variabla kryesorë, si për shembull të ardhurat e disponueshme. Rezultatet tregojnë që modeli është i qëndrueshëm, gjatë afatit të gjatë konvergon drejt ecurisë së dëshiruar, si edhe mund të jetë i përshtatshëm për simulime të ndryshme që i shërbejnë politikës monetare. Nga ana tjetër, deri tani aftësia parashikuese e modelit nuk është analizuar.

I. HYRJE

Ndërsa Banka e Shqipërisë po përgatitet për kalimin në regjimin e inflacionit të shënjestruar në të ardhmen e afërt, vendimmarrja e politikës monetare do të duhet të përdorë të gjithë informacionin e disponueshëm, që rrjedh nga të dhënat aktuale dhe vlerësimi ekonometrik. Në këtë kontekst, modeli makroekonometrik i Shqipërisë (MEAM) do të ketë një rol të rëndësishëm në këtë proces. MEAM nuk shërben vetëm për paraqitjen e një vështrimi të përgjithshëm mbi lidhjet dhe kanalet kryesore të ekonomisë, por edhe për të përmbledhur ndikimin e goditjeve të ndryshme që mund të kalojë ekonomia, si edhe për të parashikuar zhvillimet e mundshme që vijnë si pasojë e zgjedhjes së një politike të caktuar.

Informacioni që paraqitet i dobishëm për politikën monetare mund të ndahet sipas tre periudhave kryesore: zhvillimet aktuale, informacioni afatmesëm dhe ai afatgjatë. Njohja e situatës aktuale ekonomike të vendit është e domosdoshme për të vlerësuar zhvillimet e ardhshme, të cilat janë të rëndësishme për një politikë monetare me vështrim nga e ardhmja.¹ Një model makroekonomik do të ishte një mjet i dobishëm në këtë aspekt. Zhvillimet aktuale të ekonomisë përfshijnë ngjarje, të cilat do të kenë ndikime afatgjata mbi ekonominë, si edhe informacione mbi zhvillimet aktuale afatshkurtra. Në këtë kontekst, MEAM do të jetë i dobishëm, sepse lejon përcaktimin e marrëdhënieve afatgjata të ekonomisë dhe siguron informacion mbi këto lidhje. Pra, në momentin që informacioni aktual bëhet i disponueshëm, modeli e lidh këtë informacion me të gjitha marrëdhëniet ekonomike afatgjata, si dhe vlerëson ndikimin afatshkurtër të këtyre zhvillimeve. Rrjedhimisht, kur Banka e Shqipërisë do të përcaktojë projektet afatmesme, zhvillimet e afatit të shkurtër do të lidhen me vlerësimet e afatit të gjatë dhe modeli mund të funksionojë si një urë lidhëse.

Për më tepër, MEAM mund të sigurojë koherencë ndërmjet variablave të rëndësishëm ekonomikë. Edhe pse modeli nuk është një mjet mekanik, i cili do të jepte përgjigje për çdo lloj situatë, ai shërben si referim dhe si udhëzues për strukturën ekonomike.

Gjithashtu, modeli është i dobishëm për të vlerësuar rreziqet e mundshme të politikave të ndryshme, si edhe për të analizuar përgjigjen e politikës monetare ndaj goditjeve të ndryshme ekonomike. Kur analizohen politikat dhe rreziqet e mundshme, duam të shikojmë rezultatet e përfituara si pasojë e supozimeve alternative mbi variablat-kyç të ekonomisë. Analiza të tilla të variablave makroekonomikë, të përdorur në situata të ndryshme, duhet të jenë të bazuara në një model makroekonomik.

Me qëllim që të kemi një model makroekonomik të dobishëm, është e rëndësishme që të ndërtohet një mekanizëm transmetimi, i cili mund të interpretohet dhe të komunikohet lehtësisht tek përdoruesit e brendshëm si edhe jashtë Bankës së Shqipërisë. Struktura e modelit duhet të përfshijë të gjitha kanalet e nevojshme të politikës monetare, goditjet e ndryshme të ekonomisë dhe sektorët më të rëndësishëm. Modeli duhet të jetë fleksibël, në mënyrë që kur të analizohen goditje të ndryshme ekonomike, të jemi të aftë të ndryshojmë mekanizmin e transmetimit sipas nevojës. Gjithashtu, sa herë që ka një studim të ri mbi kanale individuale të transmetimit apo sa herë një informacion i ri mbi të dhënat makroekonomike bëhet i disponueshëm, duhet të përfshihen lehtësisht në makromodel. Një përjasje e pastër ekonometrike që ka për qëllim ndërtimin e një grupi ekuacionesh që përafron të dhënat, nuk rezulton gjithmonë në një model të dobishëm. Seritë e të dhënave janë zakonisht të shkurtra dhe nën ndikimin e ndryshimeve strukturore, ndërkohë që ekonomia është e karakterizuar nga një shkallë e lartë simultaniteti. Si rezultat, parametrat e vlerësuar nuk janë plotësisht të besueshëm. Për më tepër, modelet e bazuara tërësisht në anën empirike, nuk lejojnë analizimin e situatave të ndryshme të mundshme mbi mënyrën si funksionon ekonomia. Duke përmbledhur, arrijmë në përfundimin se fillimisht modeli duhet të vlerësohet nga ana empirike, në mënyrë që ekuacionet individuale të kenë një interpretim të qartë ekonomik; më vonë duhet të përdoret i gjithë informacioni dhe njohuritë e disponueshme për të ndihmuar në parametrizimin e një modeli makroekonomik strukturor.

Gjatë vitit 2007, kemi punuar për ndërtimin e një makromodeli, i cili përmbush nevojat e përmendura më sipër dhe jep një

përfaqësim të mirë të ekonomisë shqiptare. Karakteristikat afatgjata të modelit mund të kualifikohen si neoklasike, si për shembull prodhimi është i përcaktuar prej ofertës së faktorëve të prodhimit. Ndërsa, gjatë afatit të shkurtër, modeli sillet si neokejnsian: prodhimi është i përcaktuar prej kërkesës; politika monetare ndikon normat e interesit, për rrjedhojë edhe produktin dhe punësimin duke ndryshuar çmimet dhe pagat. Duke përdorur metodën VECM si përfaqësim ekonometrike, janë bërë shumë përpjekje për të kalibruar dhe për të kuantifikuar modelin duke vënë në përdorim këndvështrimin tonë mbi kanale të ndryshme transmetimi.

Sidoqoftë, ky është një proces i vazhdueshëm. Puna jonë në plotësimin e modelit dhe përcaktimin e çdo parametri, nuk ka përfunduar ende. MEAM është akoma në procesin e zhvillimit teksa informacioni i mëtejshëm bëhet i disponueshëm, dhe ndërmerren analiza të tjera empirike për të kuptuar marrëdhëniet në ekonominë shqiptare. Megjithatë, MEAM duhet të vazhdojë të jetë një mjet i rëndësishëm për të kombinuar intuitat empirike me ato teorike, të cilat shërbejnë si instrumente të çmuara për politikën monetare.

II. ZHVILLIMET GJATË VITIT 2007

Versioni i parë i MEAM i prezantuar në Tryezën e dytë të Rrumbullakët kishte si qëllim të paraqiste marrëdhëniet themelore makroekonomike të ekonomisë. Pikësynimi ishte prezantimi i një strukture të thjeshtë dhe të qëndrueshme të ekonomisë shqiptare, reagimi i variablave themelore makroekonomike si për shembull, produkti real, inflacioni, norma e interesit dhe kursi i këmbimit ndaj simulimeve të ndryshme si dhe studimi i dinamikave afatshkurtra gjatë kthimit drejt ekuilibrit. Në këtë version të parë, u identifikuan një numër kufizimesh. Këto lidheshin me vlerësimet dhe specifikimet e disa ekuacioneve, dhe gjithashtu me cilësinë e serive kohore të përdorura.

Modeli kryesisht bazohej mbi teorinë e re kejnsoniane, sipas së cilës ndryshimet në kërkesë ndikojnë produktin. Kjo strukturë

nxitej edhe më shumë nëpërmjet Kurbës së Filipsit që lidh normat e inflacionit me papunësinë. Në këtë fazë, oferta ishte e përbërë vetëm nga tregu i punës, i cili ndikonte pagat dhe papunësinë, por jo produktin. Në fund, modeli përfshinte gjithashtu, një rregull për të përcaktuar normat e interesit të politikës monetare bazuar në devijimet e inflacionit dhe hendekun e prodhimit, që nga ana tjetër ndikon normat e interesit. Në lidhje me cilësinë e të dhënave, në model u përdorën të dhëna statistikore të modifikuara dhe variabla përfaqësues për treguesit që mungojnë.

Detyra kryesore gjatë vitit 2007 ishte vlerësimi dhe kalibrimi i modelit, duke shtuar kanale që mungonin dhe informacion të ri, duke rivlerësuar kanalet ekzistuese dhe duke përmirësuar bazën e të dhënave me teknika më të mira interpolimi. Modeli i ri u shndërrua në një mjet më përfaqësues për karakteristikat e ekonomisë shqiptare dhe ato teorike. Metodologjia ekonometrike e përdorur është kointegrimi, ku mekanizmat e korigjimit të gabimit vlerësohen në dy hapa. Së pari, vlerësojmë marrëdhëniet afatgjata bazuar në teori dhe nëse është e nevojshme vendosen kufizime mbi parametrat e vlerësuar. Ekuacionet e afatit të shkurtër vlerësohen individualisht, duke marrë parasysh koeficientët e afatit të gjatë të siguruar prej hapit të parë. Të gjitha ekuacionet janë *backward-looking*, për aq kohë sa nuk kemi modeluar qartë pritshmëritë e agjentëve ekonomikë.

Një nga disavantazhet e versionit të parë të MEAM ishte përdorimi i metodës së interpolimit të Linsman për të disagreguar të dhënat vjetore në tremujore. Kjo metodë është kryesisht një përafrim matematikor dhe përdoret zakonisht për të disagreguar të dhënat vjetore. Përgjithësisht, metoda supozon që prirja e panjohur tremujore mund të paraqitet si një funksion i kohës dhe minimizon diferencën ndërmjet të dhënave vjetore të njohura dhe të dhënave tremujore të vlerësuara. Në versionin e ri të MEAM, ne përdorim metodën e rregullimit me dy hapa, siç prezantohet nga Denton (1971), për të disagreguar seritë e PBB-së dhe të konsumit. Kjo teknikë përdor tregues të tjerë me frekuencë tremujore për të disagreguar të dhënat vjetore në tremujore. Indeksi i Vëllimit Total të Shitjeve dhe Indeksi i Shitjeve me Pakicë janë përdorur përkatësisht për PBB-në dhe për konsumin.

Vlerat përfundimtare tremujore të vlerësuara sigurohen duke minimizuar një funksion kuadratik të humbjes, i cili përfshin të dhënat paraprake të vlerësuara dhe që i nënshtrohet kufizimit të agregimit. Kjo metodë e disagregimit të përkohshëm të të dhënave përdor të gjithë informacionin e disponueshëm në mënyrën më të mirë të mundshme dhe siguron një marrëdhënie logjike ndërmjet të dhënave me frekuencë të lartë dhe atyre me frekuencë të ulët.²

Aktualisht, modeli përfshin një anë të plotë të ofertës të ekonomisë, një sektor fiskal të integruar dhe kanalet kryesore të transmetimit. Modeli është funksional, konvergon në afatin e gjatë dhe përfshin më shumë stabilizues, si për shembull normat e interesit, tregun e punës, çmimet etj.. Megjithatë, duhet theksuar se lidhjet ndërmjet ofertës dhe kërkesës janë më shumë të kalibruara se sa të parashikuara: deri tani, hendeku i prodhimit dhe ndikimi i NAWRU në dinamikat e çmimeve dhe të pagave është i kufizuar.


Më poshtë prezantohen karakteristikat kryesore të versionit të ri të modelit, përjasja e re për interpolimin e të dhënave, variablat përfaqësues që janë përdorur për të zëvendësuar variablat që mungojnë, si edhe disa skenarë të mundshëm.

III. SKEMA E RE E MEKANIZMIT TË TRANSMETIMIT

Struktura e anës së kërkesës të modelit është kryesisht e njëjtë me atë të versionit të mëparshëm. Modeli është *backward-looking*, pra në të përfshihen vetëm pritje adoptive nëpërmjet vlerave të tanishme të variablave dhe atyre me vonesë kohore. Versioni i tanishëm i modelit përfshin anën komplete të ofertës, e cila përfaqëson edhe afatin e gjatë. Ana e kërkesës përfshin ndikimin e normave të interesit, kursit të këmbimit dhe të sektorit të jashtëm në ekonomi. Modeli është i pajisur me një përshkrim të detajuar të sektorit fiskal, megjithatë nuk ka një rregull të caktuar fiskal. Çmimet e brendshme janë të përcaktuara në mënyrë endogjene, ndërsa çmimet e jashtme janë ekzogjene.

Rregulli i Taylorit supozohet të përshkruajë zhvillimet kryesore të politikës monetare. Dhe së fundi, modeli përfshin edhe shkallën e përcjelljes së kursit të këmbimit, duke pasur parasysh rëndësinë e tij në ekonominë shqiptare.

Grafik 1 paraqet strukturën e versionit të ri dhe të thjeshtëzuar të MEAM, duke treguar lidhjet më të rëndësishme ndërmjet variablave. Më poshtë, jepet një përshkrim i shkurtër i karakteristikave kryesore të modelit dhe zhvillimeve gjatë vitit 2007.



Blloku i ofertës paraqet ecurinë afatgjatë të modelit dhe është i përcaktuar nga një funksion prodhimi me dy faktorë prodhimi, fuqia punëtore dhe kapitali. Forma funksionale është e tipit Cobb Douglas. Në afatin e gjatë, kërkesa potenciale për punë është e përcaktuar nga mosha e punës së popullsisë dhe nga norma ekuilibër e punësimit (NAWRU)³. Kërkesat për faktorët e prodhimit janë të derivuara duke supozuar firmat që synojnë minimizimin e kostove.

Ana e kërkesës e modelit është relativisht standarde: Konsumi është rivlerësuar duke përdorur një përafrim të ri për të ardhurat e disponueshme. Të ardhurat e disponueshme janë të ardhura të gjeneruara prej Produktit të Brendshëm Bruto ose prej Prodhimit të Brendshëm Neto duke zbritur taksat direkte dhe indirekte, më pas duke shtuar përfitimet prej sigurimeve shoqërore dhe

shëndetësore. Të ardhurat e disponueshme për Shqipërinë janë të llogaritura si më poshtë:

$$YDN = PBB + GTR_X + REM_LEK - GHSIC_R - GDIT_R - GDT_R - GO_R (1)$$

ku, PBB është Produkti i Brendshëm Bruto, GTR_X janë shpenzimet për transferta, REM_LEK janë transfertat nga emigrantët në Lek, GHSIC_R janë të ardhurat nga kontributet e institucioneve shoqërore, GDIT_R janë të ardhurat e qeverisë nëpërmjet taksave indirekte, GDT_R janë të ardhurat e qeverisë nëpërmjet taksave direkte dhe GO_R janë të ardhura të tjera.

Konsumi gjithashtu, përfshin një efekt zëvendësimi gjatë afatit të shkurtër, sepse rritjet e normave të interesit e ulin vlerën e konsumit.

Investimi (kërkesë kapitali) është i influencuar në mënyrë direkte nga normat e interesit dhe nga produkti i brendshëm në ekonomi. Eksportet dhe importet janë vlerësuar duke përdorur ndikimin e kërkesës së jashtme dhe asaj të brendshme, si edhe të çmimeve relative të eksporteve dhe importeve. Një përcim i plotë i kursit të këmbimit në çmimet e eksportit në lekë, ka një ndikim të rëndësishëm mbi eksportet. Ne kemi përfshirë një përafrim të ri për çmimet e importeve, të cilat janë të përkufizuara si një mesatare e çmimeve të eksportit të partnerëve tregtarë më të rëndësishëm të Shqipërisë⁴. Kjo vlerë e re lejon ndarjen e efektit të kursit të këmbimit në çmimet e importit nga efekti i çmimeve të jashtme.

Lidhja ndërmjet anës reale dhe asaj nominale të modelit është e përshkruar nga struktura e çmimeve dhe pagave. Çmimet e ekonomisë, siç janë të ndërtuara në model, ndikohen kryesisht nga shkalla e përcimit të kursit të këmbimit dhe nga zhvillimet në tregun e punës. Gjithashtu, inflacioni i brendshëm ndikohet nga hendeku i prodhimit. Pagat reflektojnë rezultatin e një procesi marrëveshjes, ndaj janë të përcaktuara si një funksion i niveleve të produktivitetit dhe papunësisë në ekonomi.

Politika fiskale është e modeluar me katër identitete të ardhurash dhe pesë identitete shpenzimesh. Kahu fiskal është i ndërtuar në bazë të të dhënave tremujore nominale, të publikuara nga Ministria e Financave, në vitet 1998-2006. Nuk kemi përfshirë një rregull fiskal, por kemi modeluar vëllimet e të ardhurave dhe shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë dhe si pasojë edhe borxhin e deficitit. Megjithatë, duhet vënë re, se variablat fiskalë të tanishëm shërbejnë vetëm si variabla shtesë dhe nuk kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në paga, punësim etj..

Politika monetare është e supozuar të ndjekë një politikë standarde të rregullit të Tailorit, ku devijimet e normës së interesit dhe të produktit aktual nga niveli i dëshiruar, shkaktajnë ndryshime në politikën e bankës qendrore. Rregulli është me vështrim nga e kaluara dhe gjatë supozimeve i kemi mbajtur normat e interesit konstante. Përpjekja e re për të vlerësuar hendekun e prodhimit, ndihmon për të shpjeguar më saktë dinamikën e normës së marrëveshjes së riblerjes.

Kursi i këmbimit është i përcaktuar duke marrë parasysh kombinimin e paritetit të normës së interesit të pambuluar, me paritetin e fuqisë blerëse. Ne kemi supozuar një prim rreziku konstant të reflektuar në koeficientin njësi të normave të interesit të brendshme dhe atyre të huaja. Duke supozuar që kursi i këmbimit ndjek ngjarje të kaluara dhe ndryshon vetëm në sajë të ndryshimeve në çmimet relative dhe në diferencat e normave të interesit, mund të argumentojmë që ndryshimet do të përcaktohen vetëm nga këta tregues. Në punime të ardhshme, planifikojmë të vendosim një politikë monetare me vështrim nga e ardhmja.

IV. SIMULIMET

Struktura e modelit e prezantuar më lart jep ndikimin e ekuacioneve individuale që kemi vlerësuar. Megjithatë, në mënyrë që të analizojmë dinamikën e sjelljes së modelit në përgjithësi, duhet të ndërmerren disa simulime, të cilat reflektojnë përgjigjen e modelit ndaj goditjeve të ndryshme që


mund të kalojë ekonomia shqiptare. Në këtë kontekst, kemi ndërmarrë katër simulime: një zhvlerësim i përhershëm i kursit të këmbimit, një rritje e përhershme e konsumit të qeverisë, një rënie e përhershme në totalin e faktorëve të prodhimit dhe një rritje e përhershme në kërkesën e jashtme. Simulimet u kryen gjatë një periudhe dhjetëvjeçare (1997-2006). Në model nuk u përfshi asnjë përgjigje endogjene e politikës monetare, që do të thotë, se norma e politikës dhe kursi i këmbimit u mbajtën të pandryshueshme, gjithashtu nuk u konsiderua asnjë reagim i politikës fiskale.

IV.1 NJË ZHVLERËSIM I KURSIT NOMINAL TË KËMBIMIT


Në këtë simulim është gjeneruar një zhvlerësim i përhershëm prej 1 për qind i kursit nominal të këmbimit ndaj euros. Efektet e kësaj goditjeje në ekonominë shqiptare janë të ilustruara në grafikët 2.a, 2.b dhe 2.c.

Zhvlerësimi i kursit nominal të këmbimit rrit konkurrencën e prodhuesve të brendshëm, por nga ana tjetër, çmimet më të larta të importeve shkaktojnë një rritje të IÇK (Indeksi i Çmimeve të Konsumit) dhe të pagave nominale. Investimi gjithashtu rritet gjatë vitit të parë, por konsumi i qeverisë nuk ndryshon, bazuar në supozimin që kemi marrë. Gjatë tre viteve të para, rënia në konsum dhe rritja e vogël në eksporte përgjithësisht janë mbuluar nga rritja në investim dhe në importe, ndaj PBB nuk i përgjigjet goditjes ekonomike gjatë afatit të shkurtër. Në afatin e gjatë, eksportet përgjigjen në mënyrë të dukshme dhe pasojat pozitive në PBB shfaqen kur kjo goditje ekonomike bëhet e qëndrueshme (grafik 2.b). Grafik 2.c tregon se për shkak të zhvlerësimit të kursit të këmbimit, kostoja për njësi e fuqisë punëtore dhe kërkesa për fuqi punëtore rriten, por norma e papunësisë nuk i përgjigjet goditjes ekonomike.


Grafik 2.a Përgjigje ndaj 1 për qind zhvlerësimi të përhershëm të kursit nominal të këmbimit.



Grafik 2.b Përgjigje ndaj 1 për qind zhvlerësimi të përhershëm të kursit nominal të këmbimit.




Grafik 2.c Përgjigje ndaj 1 për qind zhvlerësimi të përhershëm të kursit nominal të këmbimit.




IV.2 RITJE NË KONSUMIN E QEVERISË

Grafikët 3.a, 3.b dhe 3.c tregojnë efektet makroekonomike të një rritjeje të përhershme të shpenzimeve (të konsumit) të qeverisë prej 10 për qind. Ky simulim tregon se një rritje pozitive në konsumin e qeverisë e rrit vlerën e PBB-së gjatë vitit të parë me rreth 0.9 për qind si efekt primar. Ky efekt pozitiv nxit prodhimin dhe një investim më të lartë gjatë gjithë periudhës së simulimit. Pagat nominale dhe çmimet rriten, por çmimet përshtaten më ngadalë se pagat. Punësimi më i lartë (LD) dhe pagat nominale çojnë drejt të ardhurave të disponueshme më të larta dhe kjo shkakton një rritje në konsum. Rrjedhimisht në këtë model




dominon sjellja jo-Rikardiane. Kërkesa e brendshme më e lartë rrit nivelin e importeve, ndërsa eksportet nuk i përgjigjen kësaj goditjeje ekonomike. Efekti zinxhir i importeve e bën përgjigjen e PBB-së të venitet, siç parashikohet në një ekonomi të hapur të vogël.




IV.3 NJË GODITJE NEGATIVE OFERTE

Një goditje negative e ofertës së përhershme rezulton në një vlerë më të ulët të PBB-së për gjatë gjithë periudhës së simulimit. Kërkesa agregate më e ulët dhe të ardhurat e disponueshme më të ulëta shkaktojnë një rënie të vlerës së importeve dhe të konsumit real. Megjithatë, vihet re se eksportet rriten të mbështetura nga investimi më i lartë (grafik 4.a), të dyja falë varësisë ndaj ecurisë së kaluar. Prodhimi i ulët shkakton një rënie në pagat nominale dhe si rrjedhim, kërkesa për fuqi punëtore rritet. Vlerat më të ulëta të pagave reale rezultojnë në vlera punësimi më të larta, por prodhimi më i ulët shkakton një rritje të kostos së njësisë së fuqisë punëtore (grafik 4.c). Në fjalë të tjera, efekti i zëvendësimit dominon: një goditje negative oferte çon drejt rritjes së kërkesës për fuqi punëtore. Për shkak të kostove të brendshme të larta, do të ketë një rritje të nivelit agregat të çmimeve (grafik 4.b).


Grafik 4.a Përgjigje ndaj një uljeje të përhershme të totalit të faktorëve të prodhimit prej 1 për qind.



Grafik 4.b Përgjigje ndaj një uljeje të përhershme të totalit të faktorëve të prodhimit prej 1 për qind.




Grafik 4.c Përgjigje ndaj një uljeje të përhershme të totalit të faktorëve të prodhimit prej 1 për qind.




IV.4 RITJA E KËRKESËS BOTËRORE

Rritja e përhershme në kërkesën botërore prej 1 për qind shkakton një rritje në eksporte prej 0.8 për qind gjatë vitit të parë (grafik 5.a). Duke ditur se eksportet kanë përmbajtje të lartë importesh, më shumë eksporte rezultojnë në më shumë importe dhe efekti neto në PBB është pozitiv. Një kërkesë agregate më e lartë shkakton një rritje edhe në investime, të cilat janë të nevojshme për të mbështetur rritjen në eksporte. Të ardhurat reale të disponueshme rriten duke shkaktuar gjithashtu një rritje në konsum.


Në anën tjetër, hendeku i prodhimit rritet falë kërkesës më të lartë, e cila çon drejt një rritjeje të nivelit agregat të çmimit (grafik 5.b). Aktiviteti ekonomik i intensifikuar krijon një kërkesë më të lartë për fuqi punëtore dhe krijon paga më të larta; megjithatë, rritja e PBB-së kompenson një pjesë të asaj rritjeje, në mënyrë që rritja e kostos së njësisë së fuqisë punëtore të luhet rreth vlerës zero (grafik 5.c). Duke pasur parasysh se një rritje në prodhim, veçanërisht në eksporte, është e mbështetur nga një kërkesë më e lartë për fuqi punëtore, kjo mund të tregojë se prodhimi i Shqipërisë për jashtë vendit ka tendencën të jetë intensivisht i bazuar në fuqi punëtore.



Grafik 5.b Përgjigje ndaj rritjes së përhershme të kërkesës së jashtme prej 1 për qind.



Grafik 5.c Përgjigje ndaj rritjes së përhershme të kërkesës së jashtme prej 1 për qind.



PËRFUNDIME

Ky punim paraqet versionin e tanishëm të modelit makroekonomik të Shqipërisë (MEAM). Qëllimet kryesore janë prezantimi i skemës së re të mekanizmit të transmetimit dhe sjellja e modelit në tërësi. Efekti i situatave të ndryshme me të cilat mund të ndeshet ekonomia shqiptare në nivelin e variablave makroekonomikë, tregon se modeli është i zhvilluar mirë dhe siguron rezultate të arsyeshme. Ndaj, duke pasur parasysh se versioni i tanishëm i MEAM performon mirë në kryerjen e

simulimeve të ndryshme dhe analizave të situatave të ndryshme, atëherë ky model do të ishte një mjet shumë i përshtatshëm për politikën vendimmarrëse të Bankës së Shqipërisë në të ardhmen e afërt.

Megjithatë, ky punim duhet të konsiderohet si një prezantim i shkurtër i versionit më të fundit të modelit. Procesi i ndërtimit të modelit është akoma në progres për shkak se përmirësohet vazhdimisht. Qëllimi kryesor është që të zhvillohet një model, i cili është koherent me teorinë në afatin e gjatë, si edhe siguron një përfaqësim të mirë të ekonomisë shqiptare. Prandaj, kërkimet në të ardhmen mbi pjesë të ndryshme të makromodelit dhe mbi të dhëna të reja dhe zhvillime, do të ishin shumë të dobishme për të siguruar një perspektivë të mirë për kanalet makroekonomike të ekonomisë.

REFERENCA

Denton F.T., (1971), *Adjustment of monthly or quarterly series to annual Totals: An Approach based on quadratic Minimization*", *Journal of the American Statistical Association* 66(333)

Dushku, E. (2007), "Metodat kryesore të disagregimit të përkohshëm", *Banka e Shqipërisë*

Dushku, E., Kota, V. dhe Binaj, G. ,(2006), "Modeli makroekonomik për Shqipërinë", *Banka e Shqipërisë, Tryezë e rumbullakët mbi inflacionin e shënjestruar 2.*

Istrefi K., Semi V., (2007), "Përçimi i kursit të këmbimit në Shqipëri: evidencë nga vektorët autoregresivë", *Banka e Shqipërisë.*

Kota, V. (2007), "Metoda alternative të matjes së produktivitetit në Shqipëri", *Banka e Shqipërisë.*

Shllaku, R., (2007), "Indeksi i çmimeve/vlerave njësi të huaja të importeve shqiptare", *Banka e Shqipërisë.*

Szilard, B., Jakab, M. Z., Kovács M. A., Párkányi B., Reppa Z. and Vadas, G.(2006), "The Hungarian quarterly projection model (NEM)", *Magyar Nemzeti Bank, Occasional paper No. 60*

SHËNIME

*Vasilika Kota, Elona Dushku, specialiste, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë.

Mendimet e paraqitura në këtë material janë të autorëve dhe nuk duhet të interpretohen si reflektim i qëndrimeve të Bankës së Shqipërisë. Autorët falenderojnë z. Zoltán M. Jakab, ekonomist, Banka Qendrore e Hungarisë; z. Altin Tanku, Drejtor i Departamentit të Kërkimeve, z. Ilir Vika dhe Grupin e Ekspertëve pranë Bankës së Shqipërisë për komentet dhe sugjerimet e tyre të dobishme.

¹ Megjithatë, duhet vënë re se, për analizën e politikave të ndryshme, modelet me baza mikroekonomike që përfshijnë edhe pritjet, janë më të dobishme se modelet standarde makroekonometrike, si MEAM.

² Referohu tek “Metodat kryesore të disagregimit të përkohshëm”, Dushku (2007).

³ Non Accelerating Wage Rate of Unemployment.

⁴ Referohu tek “Indeksi i çmimeve/vlerave njësi të huaja të importeve shqiptare”, (2007), Risan Shllaku.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Vasilika Kota, Elona Dushku
Modeli MakroEkonometrik i Shqipërisë: Studim vijues /
/ Kota Vasilika, Dushku Elona - Tiranë:
Banka e Shqipërisë, Dhjetor 2009

-24 f; 15.3 x 23 cm. (material diskutimi ..)

Bibliogr.
ISBN:
978-99956-42-26-6

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

Në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:

*Banka e Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë Shqipëri,
Tel.: +355-(0)4-2222152;
Faks: +355-(0)4-2223558
ose duke dërguar një e-mail në adresën:*

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 500 kopje